



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullës Nr.01/2020, për Fletëvotimet dhe Broshurat, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas miratimit në formë elektronike më 29.10.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Miratimin e Rekomandimit të Sekretariatit të KQZ-së për Numrin e Fletëvotimeve për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar Komune

- I. Miratohet Rekomandimi i Sekretariatit të KQZ-së për numrin e fletëvotimeve për Raundin e Dytë të zgjedhjeve për Kryetar Komune, që do të mbahen më 14 nëntor 2021.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Rekomandimi si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 29.10.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Data / Datum	27.10.2021
Për / Za	Komisionin Qendror të Zgjedhjeve
Nga / Od	Burim Ahmetaj - Kryeshf Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së
Kopje / Kopija	Arkives së KQZ-së
Lënda / Predmet	Rekomandim për miratimin e numrit të fletëvotimeve raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar komune

Të nderuar Anëtarë,

Konform Planit Operacional, bazuar në Rregullën 01/2020 për Fletëvotimet dhe Broshurat, Sekretariati ka përpiluar dokumentin me numrin e fletëvotimeve për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar komune që do të mbahen me datë 14 nëntor 2021.

I. Rekomandimi për numrin e fletëvotimeve

Numri i fletëvotimeve që propozohet të shtypen është 1136750 fletëvotime. Ndërsa modaliteti i propozuar është:

a) në vendvotimet e rregullta shtypen fletëvotime me pak se votues nga -100 deri në -149

Vendvotimi	Numri i votuesve	Numri i fletëvotimeve në vendvotim (rrumbullakimi)
0101C/01R	854	750

Tabela 1. Shembull i kalkulimit të fletëvotimeve në vendvotimin e rregullt

b) në vendvotimet e dyfishta, shtypen fletëvotime me pak se votues nga -1 deri në -49

Vendvotimi	Numri i votuesve	Numri i fletëvotimeve në vendvotim (rrumbullakimi)
0101C/04D	830	800

Tabela 2. Shembull i kalkulimit të fletëvotimeve në vendvotimin e dyfishtë

c) fletëvotimet rezervë shtypen duke kalkuluar 2 % e numrit të votuesve në nivel të komunës dhe rrumbullakohet me kufirin e poshtëm sikurse tek fletëvotimet në vendvotimet e dyfishta (pika b).

d) për ekipet e VPNV-ve, kategoria e dytë, numri është përcaktuar nga Divizioni i Shërbimit votues sipas vlerësimeve nga zgjedhjet e kaluara.

Bazuar në Listën Përfundimtare të Votuesve, votues me të drejtë vote për këto këto komuna janë 1260571 votues, ndërsa do të shtypen 1136750 fletëvotime. Rrjedhimisht i bie që do të shtypen 123,821 apo 9.8 % fletëvotime më pak se votues.